



Duke u mbështetur në nenin 40. Paragrafi 40.2 nën a) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, nenit 40 nën pikën a) të Statutit të Komunës së Klinës, me kërkesën e anëtarëve të Kuvendit për Ndryshim Plotësim të Rregullores për ndarjen e bursave për studentët e Komunës së Klinës, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e I-re të radhës për vitin 2020, të mbajtur më 31.01.2020, mori këtë:

V E N D I M

Për vënie në Diskutim Publik të Draft- Ndryshimeve të Rregullores Komunale për ndarjen e bursave për studentët e Komunës së Klinës

I

Miratohet vendimi për vënien në diskutim publik të Draft-ndryshimeve dhe plotësimeve të Rregullores për ndarjen e bursave për studentët e Komunës së Klinës

II

Vënia në Diskutim publik e kësaj Projekt-Rregulloreje bëhet me qëllimin e dhënies së kontributit nga institucionet, qytetarët dhe ekspertët e fushës përkatëse, në mënyrë që e njëjta të jet sa më funksionale nga subjektet implementues dhe të tjerët.

III

Vendimi është i plotfuqishëm që nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës dhe 7 ditë pas publikimit në web faqe të komunës.

Vendimi është transparent përmes: Tabelës së shpalljeve dhe Zyrës për Inform të Komunës së Klinës

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01 Nr. 06-4717 /2020
Klinë, me 05.02 /2020

